



BASHKIA  
TIRANË

**Drejtuar: Operatorit ekonomik "STERKAJ" shpk**  
**Adresa: TIRANE Njesia Bashkiake Nr. 5, Blv. "Bajram Curri", mbrapa pallateve**  
**Agimi, Pallati 7/1B, Kati 2**

### FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

**Procedura e prokurimit: "Procedure e Hapur" "Ndërtimi i rrugës Enver Preza dhe degëzimeve të saj".**

**Përshkrim i shkurtër i kontratës: Qëllimi i kontratës është: "Ndërtimi i rrugës Enver Preza dhe degëzimeve të saj".**

**Numri i references se procedures/lotit: REF-14824-03-21-2019**

**Fondi limit: 67,860,242** (gjashtëdhjetë e shtatë milion e tetëqind e gjashtëdhjetë mijë e dyqind e dyzetë e dy) lekë pa TVSH

**Burimi i financimit:** vënë në dispozicion nga të ardhurat e Bashkisë së Tiranës në mbështetje të VKB Nr. 115 datë 27.09.2018, "Për disa ndryshime në Vendimin e Këshillit Bashkiak të Tiranës Nr. 132, datë 21.12.2017", për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2018-2020 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2018"

**Kohëzgjatja e kontratës: 6 (gjashtë) muaj** kalendarike duke nisur nga dita e lidhjes së kontratës.

**Data e zhvillimit të procedurës së prokurimit: 10.05.2019, ora 11:00**

**Publikime të mëparshme: (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike Nr. 13 datë 01.04.2019**

#### **Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:**

çmimi më i ulët **X** oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojmë se, kanë qënë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

**1. Operatori Ekonomik "Viante Konstruksion" shpk NUIS J61827083D**

**Vlera e ofertes : 48,995,115.20** (dyzetë e tetë milion e nëntëqind e nëntëdhjetë e pesë mijë e njëqind e peëmbëdhjetë pikë njëzetë) lekë.

**2. Operatori ekonomik "Kola Invest" shpk NUIS K93103401**

**Vlera e ofertes : 51,630,328.00** (pesëdhjetë e një milion e gjashtëqind e tridhjetë mijë e treqind e njëzetë e tetë) lekë.

**3. Bashkimi i operatorëve ekonomikë “K.Turja” shpk & “Infinit” shpk**  
NUIS K81314014A NUISJ74304623M

**Vlera e ofertes: 51,630,328.00** (pesëdhjetë e një milion e gjashtëqind e tridhjetë mijë e treqind e njëzetë e tetë) lekë.

**4. Operatori ekonomik “Senka” shpk** NUIS J94808405Q  
**Vlera e ofertes : 54,254,379.00** (pesëdhjetë e katër milion e dyqind e pesëdhjetë e katër mijë e treqind e shtatëdhjetë e nëntë) lekë

**5. Operatori Ekonomik “Sterkaj” shpk** NUIS J68310708M  
**Vlera e ofertes: 55,055,655.10** (pesëdhjetë e pesë milion e pesëdhjetë e pesë mijë e gjashtëqind e pesëdhjetë e pesë pikë dhjetë) lekë.

**6. Operatori Ekonomik “BE-IS” shpk** NUIS K71412003A  
**Vlera e ofertes: 55,293,787.00** (pesëdhjetë e pesë milion e dyqind e nëntëdhjetë e tre mijë e shtatëqind e tetëdhjetë e shtatë) lekë.

**7. Bashkimi i Operatorëve ekonomikë “KMK” shpk & “Varaku E” shpk**  
NUIS J10604136I NUIS J61902509S  
**Vlera e ofertes : 55,293,787.00** (pesëdhjetë e pesë milion e dyqind e nëntëdhjetë e tre mijë e shtatëqind e tetëdhjetë e shtatë) lekë.

**8. Bashkimi i Operatorëve ekonomikë “Liqeni VII” sha & “Al-Asfalt” shpk**  
NUIS K01730502W NUIS

**K81511508A**

**Vlera e ofertes: 56,842,351.00** (pesëdhjetë e gjashtë milion e tetëqind e dyzetë e dy mijë e treqind e pesëdhjetë e një) lekë.

**9. Operatori Ekonomik “Kacdedja” shpk** NUIS K51712017A  
**Vlera e ofertes: 57,347,456.25** (pesëdhjetë e shtatë milion e treqind e dyzetë e shtatë mijë e katërqind e pesëdhjetë e gjashtë pikë njëzetë e pesë) lekë.

**10. Bashkimi i Operatorëve ekonomikë “Bahas” shpk & “Avduli” shpk**  
NUIS J61827083D NUIS J66703306O  
**Vlera e ofertes: 57,407,798.00** (pesëdhjetë e shtatë milion e katërqind e shtatë mijë e shtatëqind e nëntëdhjetë e tetë) lekë

**11. Bashkimi i Operatorëve ekonomikë “Sireta 2F” shpk & “EuroAlb”shpk**

NUIS K51501008J NUIS K66613407H

**Vlera e ofertes: 63,333,333.00** (gjashtëdhjetë e tre milion e treqind e tridhjetë e tre mijë e treqind e tridhjetë e tre) lekë.

**Janë skualifikuar Operatorët ekonomik të mëposhtëm:  
Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:**

**1. Operatori ekonomik “Viante Konstruksion” shpk; NUIS J61827083D**

- Operatori ekonomik “Viante Konstruksion” shpk nuk plotëson pikën 5 të Kapacitetit Teknik të Dokumentave Standarte të Tenderit: “Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë të punësuar staf teknik për kryerjen e të gjitha punimeve në këtë objekt...1 (një) inxhinier Mjedisi (i pajisur me çertifikatë lëshuar nga Ministria e Mjedisit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis)” pasi për inxhinierin e mjedisit nuk është paraqitur Çertifikata për vlerësimin e ndikimit në mjedis.
- Operatori ekonomik “Viante Konstruksion” nuk plotëson pikën 8 të Kapacitetit Teknik të Dokumentave Standarte të Tenderit: “Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar minimalisht 4 (katër) punonjës manovratorë të mjeteve të rënda...” pasi nga 4 manovratorë të kërkuar, njëri prej tyre, Gj. Bezati rezulton edhe inxhinierie ndërtimi në përmbushje të kërkesës për stafin inxhinierik si dhe është deklaruar Drejtues Teknik.
- Operatori ekonomik “Viante Konstruksion” shpk nuk plotëson pikën 17 të Kapacitetit Teknik të Dokumentave Standarte të Tenderit: “Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutim in e kontratë (Shtojca 10)” pasi të gjitha mjetet që ka deklaruar në pronësi dhe të marra me qera konkretisht nga subjektet: “Isobar construction”, “Minado Construction”, “Komjani”, “Sina98”, “DSDrilling”, “Kurt07\_1”, “Kurti07\_2”, “RenGroup”, “Beladi”, “Xhulio”, “AuroraKonstruksion\_1\_2\_3” “Mane-S”, “Start Co”, “Skela Sylja” rezultojnë të deklaruara dhe angazhuara në kontratën e lidhur me Bashkinë Tiranë me objekt: “Ndërtimi i rrugës së shkollës 9-vjecare Ymer Kurti, fshati Lagje e re”, datë 30.04.2019 e cila I vazhdon efektet ligjore-teknike-financiare.
- Operatori ekonomik “Viante Konstruksion” shpk nuk plotëson pikën 17 të Kapacitetit Teknik të Dokumentave Standarte të Tenderit: “Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutim in e kontratë (Shtojca 10)” pasi mjetet me e marra me qera nga operatori ekonomik “Euroalb” shpk rezultojnë të deklaruara nga ky operator ekonomik në ofertën e tij për këtë procedurë prokurimi.
- Operatori ekonomik “Viante Konstruksion” shpk nuk plotëson pikën 17 të Kapacitetit Teknik të Dokumentave Standarte të Tenderit: “Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutim in e kontratë (Shtojca 10)” pasi referuar mjeteve të deklaruara sit ë marra me qera nga subjektet: “Vjollca Hoxha”, “Paluca”, “Ales Construction”, “Vagalat”, “Madrid” nuk rezultojnë mjetet: Autobetoniere, fadromë me goma, autovinc, asfaltoshtruese, vibrator betony, rrul me kompresor, rrul me vibrim, grejder, elektrosaldatrice.
- Operatori ekonomik “Viante Konstruksion” shpk nuk plotëson pikën 1, gërma “c” të kriterëve të Vecanta të Dokumentave Standarte të tenderit: “Formulari i Ofertës, sipas Shtojces 1”, pasi u konstatua se Preventivi është paraqitur me ndryshim të strukturës, në sasi dhe volum cka bie në kundërshtim me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë të përcaktuar në Dokumentat Standarte të Tenderit, Seksioni 2 Përlllogaritja e ofertës ekonomike.

**2. Oferta e paraqitur nga operatori ekonomik “Kola Invest”shpk**

**NUIS K93103401G**

- Operatori ekonomik “Kola Invest” shpk nuk plotëson pikën 17 të Kapacitetit Teknik të Dokumentave Standarte të Tenderit: “Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në

dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutim in e kontratë (Shtojca 10)/eskavator me goma” pasi pasi eskavatori me goma është paraqitur vetëm me faturë zhdoganimi cka bie në kundërshtim me përcaktimin e gërmës “a” të kësaj pike.

•Operatori ekonomik “Kola Invest” shpk nuk plotëson pikën 1, gërma “c” të kriterëve të Vecanta të Dokumentave Standarte të tenderit: “Formulari i Ofertës, sipas Shtojces 1”, pasi u konstatua se Preventivi është paraqitur me ndryshim të strukturës, në sasi konkretisht zëri 11 “Punime për murin rrethues”, ml mur rrethues është ndryshuar sasia cka bie në kundërshtim me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë të përcaktuar në Dokumentat Standarte të Tenderit, Seksioni 2 Përlllogaritja e ofertës ekonomike.

### **3. Oferta e paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “K.Turja” shpk & “Infinit” shpk ; NUIS K81314014A NUISJ74304623M**

- Operatori ekonomik “K.Turja” shpk nuk plotëson Kriteret e Përgjithshme: “Këto kritere duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 8” pasi kjo shtojcë nuk është paraqitur sipas formatit të përcaktuar në DST.
- Operatori ekonomik “Infinit” shpk nuk plotëson Kriteret e Përgjithshme: “Këto kritere duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 8” pasi kjo shtojcë nuk është paraqitur sipas formatit të përcaktuar në DST.
- Operatori ekonomik “K.Turja” shpk nuk plotëson gërmën “e” të kriterëve të vecanta të pikës 2: “Deklarate mbi kontratat e lidhura apo ne proces, sipas Shtojcës 11” nuk ka deklaruar sipas shtojces 11 per kontratat e lidhura dhe ato ne proces, nuk ka deklaruar kontraten e lidhur me Bashkine Tirane “Rikonstruksion i rruges Sotir Peci”.
- Operatori ekonomik “Infinit” shpk nuk plotëson gërmën “c” të pikës 2 të kapacitetit teknik: “Liçensa profesionale,lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës....” pasi nuk disponon Piken e Licences NP 12 per punime te inxhinierise se Mjedisit.
- Operatori ekonomik “K.Turja” shpk nuk plotëson gërmën “c” të pikës 2 të kapacitetit teknik: “Liçensa profesionale,lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës....” pasi nuk disponon piken NP 4 B te Licences per Rruge Autostrata, etj sic percaktohet ne DST.
- Operatori ekonomik “Infinit” shpk nuk disponon licensen nga QKL III 2 B sic percaktuar ne DST pika 16 Krietret e Vecanta te Kualifikimit: “Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me Licencë lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licensimit për grumbullim dhe transportim të mbetjeve që kanë ndikim në mjedis (Kodi III.2.B).
- Operatori ekonomik “K.Turja” nuk plotëon pikën 17 të kapacitetit teknik të Dokumentave Standarte të Tenderit: “Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratë (Shtojca 10)” pasi mjetet e deklaruar: Asfaltoshtruese, Autobot uji, eskavator Ime targe AEMT61, Autovinc me targe TR6841P, Kamion veteshkarkues me targe AA086EK, Kamion veteshkarkues me targe AA752SM, si dhe njëra nga kamioncinat rezultojnë të angazhuara në kontratën e lidhur me bashkinë Tiranë me objekt: Rikonstruksioni I rrugës Sotir Peci” e cila nuk I ka përfunduar efektet ligjore-financiare-teknike.

### **4. Oferta e paraqitur nga operatori ekonomik “Senka” shpk NUIS J94808405Q**

- Operatori ekonomik “Senka” shpk nuk plotëson Kriteret e Përgjithshme: “Këto kritere duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 8” pasi kjo shtojcë nuk është paraqitur sipas formatit të përcaktuar në DST.
- Operatori ekonomik “Senka” shpk nuk plotëson gërmën “f” të kapacitetit teknik të Dokumentave Standarte të Tenderit: “Makinëritë e mësipërme nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera dhe nuk janë të deklaruara në procedurat të shpallura fitues nga autoriteti kontraktor, Bashkia Tirane. (Deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese ku të deklarohet dhe vendndodhja e mjeteve në pronësi ose me qera me qellim verifikimi)” nuk është paraqitur Deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese ku të deklarohet dhe vendndodhja e mjeteve në pronësi ose me qera me qellim verifikimi.
- Operatori ekonomik “Senka” shpk nuk plotëson gërmën “d” të pikës 17 të kapacitetit teknik të Dokumentave Standarte të Tenderit: “Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilin mjet të deklaruar ku të jetë e dukshme dhe targa e mjetit pasi” për kamionin me kapacitet 15-20 ton me targë AA718RO nuk është paraqitur foto.
- Operatori ekonomik “Senka” shpk nuk plotëson pikën 17 të kapacitetit teknik të Dokumentave Standarte të Tenderit: “Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutim in e kontratë (Shtojca 10)” pasi mjetet Autobetoniere me targa TR1485N dhe TR2516M rezultojnë kamionë të certifikuar për transport mallrash brend vendit për llogari të vet.

#### 5. Oferta e paraqitur nga operatori ekonomik “BE-IS” shpk NUIS K71412003A

- Operatori ekonomik “BE-IS” shpk nuk plotëson pikën 4 të Kapacitetit Teknik të Dokumentave Standarte të tenderit: “Një punësim mesatar i të paktën 55 (pesëdhjetë e pesë) personave, për periudhën Mars 2018 - Mars 2019 të vërtetuar me...”, pasi referuar kontratave të nënshkruara midis operatorit ekonomik dhe Bashkisë Tiranë me objekt: 1. “Rikualifikim urban i Bllokut Nr. 1 (Lapraka) kufizuar nga rrugët “Don Bosko” – “Shinat e Trenit (Filanto) – “Turhan Pashë Përmeti” – “Ibrahim Pashë Bushatlliu” – “Lord Bajron” – “Riza Cuka” – “Learton Vathi” – “Pandi Dardha” – “Dritan Hoxha”; 2. “Ndërtimi i rrugëve ”Migjeni dhe Kadri Roshi” në Njësinë Administrative Kashar, Faza I”; 3. “Ndërtimi i rrugëve ”Migjeni dhe Kadri Roshi” në Njësinë Administrative Kashar, Faza II”; 4. “Rehabilitim i rrugës dhe qendrës së lagjes Sheheler”, të cilat nuk i kanë përfunduar efektet tekniko-financiare, si dhe referuar diferencës midis numrit të punonjesve të anagazhuar në keto kontrata dhe punësimit mesatar të operatorit ekonomik rezulton një numër i pamjaftueshëm punonjësish.

#### 6. Oferta e paraqitur nga operatori ekonomik “Kacdedja” shpk NUIS K51712017A

- Operatori ekonomik “Kacdedja” shpk nuk disponon licensen nga QKL III 2 B sic përcaktuar në DST pika 16 Kriteret e Vecanta të Kualifikimit: “Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me Licencë lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licensimit për grumbullim dhe transportim të mbetjeve që kanë ndikim në mjedis (Kodi III.2.B).

- Operatori ekonomik “Kacdedja” shpk nuk plotëson pikën 17 të kapacitetit teknik të Dokumentave Standarte të Tenderit: “Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutim in e kontratë (Shtojca 10)” pasi është dekalruar vetëm 1 (një) kamion me kapacitet 10-15 ton nga 2 të kërkuar.
- Operatori ekonomik “Kacdedja” shpk nuk plotësojnë pikën 17 të kapacitetit teknik të Dokumentave Standarte të Tenderit: “Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutim in e kontratë (Shtojca 10)” pasi është dekalruar vetëm 1 (një) autobetoniere nga 2 të kërkuar.

**7. Oferta e paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “Sireta 2F” shpk & “EuroAlb” shpk .**  
**NUIS K51501008J NUIS K66613407H**

- Operatori ekonomik “EuroAlb” shpk nuk plotëson pikën 6 të kapacitetit teknik të DST: “Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë pjesë të stafit të punësuar, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, Urdhër mjeku, diplomë, librezë pune dhe të figurojë në listëpagesa, 1 (një) mjek të përgjithshëm” pasi nuk ka paraqitur dokumentacion për mjekun e kërkuar.
- Bashkimi i operatorëve ekonomikë “Sireta 2F” shpk & “EuroAlb” shpk nuk plotëson pikën 17 të kapacitetit teknik të DST: “Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutim in e kontratë (Shtojca 10)” pasi nuk është deklaruar asnjë kamion me kapacitet mbajtës 10-15 ton dhe është deklaruar vetëm 1 (një) nga 2 (dy) autobetoniere të kërkuara.
- Operatori ekonomik “EuroAlb” shpk nuk plotëson pikën 17 të kapacitetit teknik të DST: “Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutim in e kontratë (Shtojca 10)” pasi mjetet e deklaruara rezultojnë t’ja ketë dhënë eme qera operatorit ekonomik “Viante KONstruksion” I cili është pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë **Operatorin ekonomik “Sterkaj” shpk**, me adresë: **TIRANE Njesia Bashkiake Nr. 5, Blv. "Bajram Curri", mbrapa pallateve Agimi, Pallati 7/1B, Kati 2**, se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme **55,055,655.10** (pesëdhjetë e pesë milion e pesëdhjetë e pesë mijë e gjashtëqind e pesëdhjetë e pesë pikë dhjetë) lekë, është identifikuar si **oferta e suksesshme**.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Bashkisë së Tiranës, Sheshi Skënderbej, Nd. 2, Kodi Postar 1001, Tiranë, Shqipëri sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e marrjes së këtij njoftimi.

**Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë: 24.05.2019**

Gjatë afatit ligjor për pritjen e ankesave nga shoqëritë pjesëmarrëse në tender në mbështetje të Nenit 63 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) si dhe në bazë të Kreut X, Neni 78 të VKM-së Nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar), pranë Autoritetit Kontraktor, Bashkia Tiranë, nuk është paraqitur asnjë ankesë.

